



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 06

Datë: 30. 03. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.04 dhe 05 /2017;*

2. Aktivitetet e ZRPP-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit lidhur me kërkesën e PP-së*

“ NISMA PËR KOSOVËN ”, për lejimin e pagesës së gjobës së shqiptuar nga PZAP në tri këste;

3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- **Këshilli për Çështje Ligjore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Obiliq, Ferizaj dhe Skenderaj;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Zyrës të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për caktimin e një përfaqësuesi të KQZ-së në ekipin punues për hartimin dhe finalizimin e koncept dokumentit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike;*
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit, Pasqyrat e përmbajtjes së vlerësimit të rreziqeve për KQZ-në;*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për ridizajnimin e ueb faqes së KQZ-së;*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit për Monitorim dhe Vlerësim;*
 - 4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Grupit për Qasje në Zgjedhje për caktimin e anëtarëve të KQZ-së në këtë grup;**
 - 5. Vlerësimi vjetor i punës të Kryeshefit Ekzekutiv në SKQZ.**
 - 6. Të ndryshme**
-

1. Hyrje

Valdete Daka: Sa i përketë rendit të ditës, a kemi ndonjë propozim...? Nëse nuk ka, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rendin e ditës dhe pastaj, shqyrtuan dhe miratuan procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së nr.04, dhe 05/2017.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit lidhur me kërkesën e PP-së " NISMA PËR KOSOVEN ", për lejimin e paqesës se qjobës së shqiptuar nga PZAP në tri këste

Miradije Mavriqi: Zyra ka përgatitur rekomandimin lidhur me kërkesën e Nismës që, në bazë të një gjobe të shqiptuar nga PZAP, të lejoj KQZ që kjo gjobë të paguhet përmes tri kësteve nga fondi apo buxheti për partitë politike. Po ashtu, është edhe draftvendimi për Partinë Demokratike të Kosovës së cilës, duhet t'i ndahet nga fondi një shumë prej 4 200 euro. Është fjala për një gjobë të cilën, ia ka shqiptuar PZAP. Nuk kemi përgatitur rekomandim të posaçëm. Kjo parti, nuk ka kërkuar ndarjen e borgjit në këste.

Valdete Daka: Të vendosim njëherë për Nismen, e pastaj për PDK-në.

Binak Vishaj: Edhe në të kaluarën kemi pasur kërkesa të ngjashme, e të cilat KQZ i ka miratuar si kërkesa, pra ju ka mundësuar partive politike që t'i shlyejnë borxhet me këste. Një prej tyre, është edhe AAK së cilës, ju ka mundësua shlyerja e borgjit nga KQZ. Nuk besoj që kjo paraqet problem për KQZ-në.

Adnan Rrustemi: Edhe unë e përkrahu këtë formë. Kemi pasur edhe në të kaluarën raste të ngjashme. Mirëpo, po pyes se a kemi rregullim specifik, nuk po flas për këtë rast se, kjo nuk është shumë e madhe. Mirëpo, mund të kemi edhe shuma të mëdha...!

Miradije Mavqiqi: Alokimi i mjeteve bëhet në çdo tre muaj, dhe për këtë ne e kemi ndarë këtë në tre këste.

Bajram Ljatifi: Duhet ta kemi parasysh faktin se, nëse subjektet gabojnë dhe gjobiten shpesh, duhet t'i shqyrtojmë rrethanat, sepse bëhet fjalë për mjete...

Eshref Vishi: Kjo është hera e parë...

Betim Gjoshi: Nuk kam ndonjë kundërshtim të veçantë, mirëpo në rast se shpërbëhet parlamenti për shembull, nuk mund t' merren paratë, kështu që keni kujdes... Pastaj, gjobat janë detyrim dhe s'kemi nevojë të marrim fare vendim...

Adnan Rrustemi: Ne nuk marrim vendim për pagesë, por marrim vendim për ndalesë...

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Obiliq, Ferizaj dhe Skenderaj*

Sami Hamiti: Në mes të dy takimeve të KQZ-së, kemi mbajtur mbledhje të këshillit, bile një mbledhje na ka dështuar. Pra, të kemi konsensus, dhe Sekretariati ti caktojë mbledhjet dhe ato të mos mbahen ad-hok. Pra, në takim, kemi shqyrtuar kërkesat për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Obiliq, Ferizaj dhe Skenderajt. Në të tri rastet, nga zyra Ligjore është konstatuar se në të tri këto raste janë përmbushur kushtet ligjore për zëvendësime të këtyre anëtarëve të asambleve.

Valdete Daka: Kush është që Teuta Berisha të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Obiliq nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme të këtij kuvendi, Luljeta Ibrahim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë zëvendësim.

Valdete Daka: Kush është që Lulëzim Abazi, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të këtij kuvendi, Lulëzim Aliu.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë zëvendësim.

Valdete Daka: Kush është që Musa Fazliu të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Skënderaj nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme të këtij kuvendi, Ardita Nura.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë zëvendësim.

Betim Gjoshi: Me leje, nuk kam kundër asgjë por, lidhur me përgatitjen e agjendave të mbledhjeve, po na kalojnë afatet e ndryshme, rekomandimet etj. Kështu që, së paku një mbledhje në javë, ta kemi të rregullt.

Në këtë pikë, foli edhe Adnan Rustemi, dhe kërkoi që të respektohet rregullorja e punës. Ai tha se, duhet t'i kthehemi rregullit të punës, veç ndonjë rasti të veçantë.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Zyrës të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për caktimin e një përfaqësuesi të KQZ-së në ekipin punues për hartimin dhe finalizimin e koncept dokumentit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike

Sami Hamiti: E kemi shqyrtuar edhe kërkesën që ka ardhur nga zyra e Kryeministrit, dhe duke e ditur rëndësinë e këtij ligji edhe për KQZ-në, dhe, edhe për partitë politike, por duke pasur parasysh edhe mangësitë e këtij ligji: Në parim, duke pasur parasysh edhe funksionet, në këshill jemi akorduar që të shkojë drejtoresha e ZRPP-së si dhe kryetarja e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime caktimin e një përfaqësuesi të KQZ-së në ekipin punues për hartimin dhe finalizimin e koncept dokumentit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike .

4.Këshilli për Operacione Zgjedhore

- *Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit, Pasqyrat e përmbajtjes së vlerësimit të rreziqeve për KQZ-në;*

Adnan Rustemi: Në mbledhjen e fundit të KOZ-it, kemi shqyrtuar pasqyrat e përmbajtjes së vlerësimit të rreziqeve për KQZ-në. Ky dokument, synon që të nxjerrë një grup, qoftë nga Sekretariati dhe qoftë si të përzier me KQZ-në. Nuk po lëshohem në detale, por në kuadër të politikave të veta, KQZ duhet të vendos se si do të veprojë, si do të vlerësoj në kontekst të rreziqeve të ndryshme...! Miratimi dhe shqyrtimi në KQZ i këtij dokumenti, mendoj që duhet të jetë i bazuar dhe, t'i ketë parasysh qasjet konkrete.

Betim Gjoshi: Mendoj që, edhe KQZ duhet të jetë e kyçur në implementimin e këtij dokumenti.

Binak Vishaj: Mendoj që ekipi duhet të jetë i përzier...

Adnan Rustemi: Avantazhet dhe disavantazhet, nuk preferojnë se cilin model ta kemi. Por, të gjithë duhet të vlerësojmë se, sa mund të angazhohemi. Ky dokument, madje kalon edhe nëpër këshilla, dhe ne do të jemi të involvuar.

Valdete Daka: Rekomandim konkret nga këshilli nuk kemi, prandaj unë po e qes në votim propozimin e z. Binaku, që grupi të jetë mikst. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me një abstenim (Adnan Rustemi), dokumentin “Pasqyrat e përmbajtjes së vlerësimit të rreziqeve për KQZ”-në.

Valdete Daka: Ne mund t’i caktojmë anëtarët nga Sekretariati, dhe Sekretariati t’i caktoj të vetët, dhe nuk duhet të jenë më shumë se 10 persona.

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për ridizajnimin e ueb faqes së KQZ-së

Adnan Rustemi: E kemi shqyrtuar edhe këtë projekt. Nuk po lëshohem në detaje, nga Sekretariati mund të kemi informacione të caktuara. Me sa kam parë, projekti është i qartë, dhe profesional. Dhe ne, rekomandojmë të aprovohet.

Në këtë pikë, diskutuan: Betim Gjoshi, Binak Vishaj.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë projekt.

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit për Monitorim dhe Vlerësim

Adnan Rustemi: Ky është një dokument, më saktë një nën dokument që rrjedhën nga plani strategjik i KQZ-së. Është një mekanizëm që mbikëqyrë, dhe drejton planin strategjik dhe i ka të renditur indikatorët në përputhje me shtyllat e planit strategjik. Janë gjithsej, 8 indikatorë...Ne e kemi shqyrtuar, dhe rekomandojmë që plan monitorimi të miratohet...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë plan monitorimi dhe vlerësimi.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Grupit për Qasje në Zgjedhje për caktimin e anëtarëve të KQZ-së në këtë grup

Valdete Daka: E hapi diskutimin për këtë pikë...! Duhet t’i caktojmë anëtarët nga KQZ që do të marrin pjesë në këtë grup që përfaqësojnë organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

Adnan Rustemi: E përkrahu këtë kërkesë, sado që nuk e kam krejt të qartë kërkesën...Pra, janë 4 anëtar...Po, unë jam për, sepse, ne duhet të kontribuojmë...

Betim Gjoshi: Ne, kemi punuar që krejt kategoritë e votuesve të ndjehen të barabartë në procesin e zgjedhjeve. Por, ne duhet ta mbajmë institucionin të mirë informuar. Ne, e kemi përgjegjësi, dhe është mirë që të koordinohemi. E përkrahi kërkesën...!

Valdete Daka: Meqë, përbërja e grupit është vullnetare, dhe nga ne është kërkuar që të delegohen 2- 3 persona...!

Adnan Rustemi: Ky përfaqësim, mund të formalizohet sot nga ana jonë. Ne sot duhet të marrim vendim, dhe ne në KQZ mund të marrim vendim, kurse Sekretariati të merr vendim...

Bajram Ljatifi: Edhe pse bëhet fjalë për grup jo formal, vullnetar, ne nga KQZ duhet të marrim pjesë...Ne, ta formojmë grupin...!

Pjesë e këtij grupi nga KQZ, janë: Bajram Ljatifi, Betim Gjoshi dhe Binak Vishaj. Nga Sekretariati (...)

6.Vlerësimi vjetor i punës të Kryeshefit Ekzekutiv në SKQZ

(Në vazhdim, mbledhja ka vijuar me dyer të mbyllura)

7. Të ndryshme

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
